L I G J
Nr.9314, datë 11.11.2004

PËR PRIVATIZIMIN E AKSIONEVE, PRONË E SHTETIT SHQIPTAR, TË BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË

(Ndryshuar me ligjin nr. 9540, datë 22.5.2006)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ministria e Financave, me cilësinë e pronarit, lejohet, në emër të shtetit shqiptar, të transferojë të drejtën e pronësisë nëpërmjet shitjes së 40 për qind të aksioneve të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë.

Neni 2

Aksionet, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë, t'u ofrohen për shitje, fillimisht, aksionerëve të kësaj banke, sipas legjislacionit në fuqi dhe aktit të themelimit të saj.

Neni 3

Transferimi i të drejtës së pronësisë të këtyre aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë, tek aksionerët e kësaj banke të kryhet vetëm pas vlerësimit të çmimit të aksioneve nga një vlerësues i njohur ndërkombëtar, i përzgjedhur me tender të hapur ndërkombëtar.

Neni 4
(Ndryshuar fjalë në pikën 1, rreshti i dytë me ligjin nr. 9540, datë 22.5.2006)

1. Nëse shitja e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë nuk realizohet brenda datës 31.12.2006, sipas parashikimeve të nenit 2 të këtij ligji, Ministria e Financave ka të drejtën t'ia shesë ato, nëpërmjet tenderit të hapur, një investitori strategjik të njohur në sektorin bankar, i cili ofron garanci financiare.
2. Procedurat e përzgjedhjes së investitorit strategjik, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 5

Përcaktimi i vlerës së aksioneve për fillimin e procedurave të tenderit, sipas parashikimeve të nenit 4 të këtij ligji, bëhet pas vlerësimit të aksioneve të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë nga një vlerësues ndërkombëtar, i përzgjedhur me tender të hapur ndërkombëtar.

Neni 6

Këshilli i Ministrave miraton vlerën e aksioneve, të përcaktuar nga vlerësuesi ndërkombëtar, sipas parashikimeve të neneve 3 e 5 të këtij ligji.

Neni 7

1. Të ardhurat që sigurohen nga privatizimi i aksioneve të kësaj banke derdhen në Buxhetin e Shtetit pasi të jenë zbritur shpenzimet që do të përdoren për realizimin e procesit te shitjes, të cilat nuk duhet të kalojnë shumën 10 për qind të vlerës së shitjes.

2. Kriteret për përdorimin e shumës deri në 10 për qind të vlerës së shitjes, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4416, datë 13.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Aldred Moisiu